



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
SENATI AKADEMIK

Nr. 2038/ Prot.
25

Tiranë, më 05.03.2018

VENDIM QARKULLUES

Nr. 18, datë 05.03.2018

“PËR SHPËRNDARJEN E KUOTAVE TË PRANIMIT DHE TARIFAT E SHKOLLIMIT NË PROGRAMET E SPECIALIZIMEVE AFATGJATA, NË FUSHËN E MJEKËSISË, PËR VITIN AKADEMIK 2017-2018”


Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, neni 25, neni 38, neni 42, neni 69, neni 78, Statutit dhe Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, Rregullores së studimeve të specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë, në fushën e mjekësisë, Vendimit Nr. 14, datë 31.01.2018 të Senatit Akademik të UMT-së, propozimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Mbrojtjes dhe Ministrisë së Drejtësisë, Senati Akademik i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë,

VENDOSI:

1. Kuotat e pranimit në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2017-2018, janë 247 për kandidatët brenda territorit të vendit, të ndara, si më poshtë:

a) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	125;
b) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministria e Mbrojtjes	16;
c) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministria e Brendshme	2;
d) Kuota pranimi të mbuluara nga Ministria e Drejtësisë	9
e) Kuota të lira (të pa mbuluara)	95;
2. Kuota për transferim studimesh në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, për vitin akademik 2017-2018, janë 12 kuota.


3. Kuotat e pranimit për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën 1/a, b, c, d, e, të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi.
4. Kuotat e pranimit për transferim studimesh për programet e specializimeve afatgjata, të ciklit të tretë të studimeve, me kohë të plotë, të përcaktuara në pikën 2 të këtij vendimi, të ndara sipas programeve të studimit, pasqyrohen në tabelën nr.2, bashkëlidhur këtij vendimi.
5. Aplikojnë, për programe studimi specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, të gjithë kandidatët që kanë fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, sipas përcaktimeve në rregulloren përkatëse të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë.
6. Pranimet e studentëve në programin specializues afatgjatë, në numrin përkatës të kuotës së përcaktuar në këtë vendim, bëhen sipas përcaktimeve në rregulloren e specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, të udhëzimit përkatës të Rektorit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, si dhe të akteve ligjore e nënligjore në fuqi.
7. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh (në total 4 kuota), sipas tabelës 2, janë shpërndarë mbështetur në kërkesat e Ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, bazuar në nevojat e shërbimit shëndetësor për mjekë të specializuar. Studenti transferohet nga programe specializuese afatgjata, të ngjashme, të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.
8. Kuotat e pranimeve për transferim studimesh (në total 8 kuota) shpërndahen nga rektori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bazuar në propozimin e dekanateve sipas kërkesave të aplikantëve që vijnë nga institucione të tjera të arsimit të lartë, në programe specializuese afatgjata të njëjta apo të të njëjtit profil. Studentët e transferuar nuk mund të regjistrohen në vite më të larta se viti i dytë i studimeve të programit përkatës specializues.
9. Tarifa e konkurrimit në programet specializuese afatgjatë apo tarifa e aplikimit për transferim studimesh është 5000 (pesëmijë) lekë. Tarifa vjetore e shkollimit për studentët që ndjekin programet specializuese afatgjata në fushën e mjekësisë, sipas përcaktimeve të këtij vendimi është 115000 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë) lekë (tarifa e konkurrimit/aplikimit dhe tarifa e shkollimit është e njëjtë me tarifën e vitit të mëparshëm akademik). Studentët e shpallur fitues paguajnë/arkëtojnë, menjëherë 30% të tarifës vjetore të shkollimit, ndërsa këstet e tjera arkëtohen sipas afateve dhe masës në përqindje të përcaktuara nga fakultetet përkatëse.
10. Studenti, i cilësuar, në bazë të rregullores së institucionit të arsimit të lartë publik, si përsëritës, i nënshtrohet tarifës së plotë vjetore të shkollimit, të vitit akademik në të cilin vazhdon studimet.
11. Studentët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara sipas pikës 1/a, b, c, d dhe pikës 7 të këtij vendimi, lidhin kontrata, përkatësisht me ministrinë përkatëse ku përcaktohen detyrimet mes palëve si dhe



penalitetet, në rastet e mosrespektimit të tyre. Modeli i kontratës dhe modalitetet e lidhjes së saj përcaktohen nga ministria që mbulon fushën përkatëse dhe i bëhen të ditura kandidatit para hapjes së procesit të aplikimeve.

12. Kandidatët që përfitojnë nga kuotat e parashikuara në pikën 11 të këtij vendimi, duhet të paraqesin, në momentin e aplikimit, shkresë mbështetëse nga ministria përkatëse.
13. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i njësive kryesore përkatëse të UMT-së, pa efekte buxhetore shtesë.
14. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, bëhet publik në faqen zyrtare të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, dhe përcillet për zbatim Fakultetit të Mjekësisë, Fakultetit të Mjekësisë, Dentare dhe Qendrës së Shërbimeve Arsimore për vijimin e mëtejshëm të procedurave të përcaktuara në Rregulloren e studimeve të specializimeve afatgjata në fuqi

**KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
ARBEN GJATA**



**Kuotat e pranimit për programet e studimeve të specializimeve afatgjata në fushën e mjekësisë,
në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë për vitin akademik 2017-2018**

Tabela nr. 1

Nr.	Fakulteti	Programi i studimit	Ministria e Shëndetësisë dhe MS	Ministria e Mbrojtjes	Ministria e Brendshme	Ministria e Drejtësisë	Kuota të lira	Kuota gjithsej
1	Fakulteti i Mjekësisë	Alergologji	3	1		1		5
2	Fakulteti i Mjekësisë	Anatomi patologjike	5					5
3	Fakulteti i Mjekësisë	Anestezi-reanimacion	8					8
4	Fakulteti i Mjekësisë	Hematologji	2				3	5
5	Fakulteti i Mjekësisë	Diagnozë me imazhe	8					8
6	Fakulteti i Mjekësisë	Endokrinologji	5					5
7	Fakulteti i Mjekësisë	Gastrohepatologji	2				3	5
8	Fakulteti i Mjekësisë	Kardiologji	8					8
9	Fakulteti i Mjekësisë	Kirurgji e përgjithshme	4	2		1	3	10
10	Fakulteti i Mjekësisë	Laborator klinik- biokimik		1		2	2	5
11	Fakulteti i Mjekësisë	Mikrobiologji		1			4	5
12	Fakulteti i Mjekësisë	Mjek familjeje					20	20
13	Fakulteti i Mjekësisë	Mjekësi interne	10					10
14	Fakulteti i Mjekësisë	Mjekësi e ujqencës	12					12
15	Fakulteti i Mjekësisë	Mjekësi transfuzive					5	5
16	Fakulteti i Mjekësisë	Nefrologji	3	1			1	5
17	Fakulteti i Mjekësisë	Neurologji	4	2	1			7
18	Fakulteti i Mjekësisë	ORL	2	1			2	5
19	Fakulteti i Mjekësisë	Obstetrikë-gjinekologji	6	2				8
20	Fakulteti i Mjekësisë	Okulistikë	4	1				5
21	Fakulteti i Mjekësisë	Onkologji					8	8
22	Fakulteti i Mjekësisë	Ortopedi - traumatologji	2	2			1	5
23	Fakulteti i Mjekësisë	Pediatri	20					20
24	Fakulteti i Mjekësisë	Pneumologji	3	1	1		1	6
25	Fakulteti i Mjekësisë	Psikiatri	10			4	1	15
26	Fakulteti i Mjekësisë	Psikiatri e fëmijëve dhe adoleshentëve				1	6	7
27	Fakulteti i Mjekësisë	Reumatologji	2	1			2	5
28	Fakulteti i Mjekësisë	Sëmundje infektive	2				3	5
29	Fakulteti i Mjekësisë	Shëndet publik					15	15
30	Fakulteti i Mjekësisë	Kirurgji Plastike, Rikonstrutive dhe Estetike					5	5
31	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Pedodonti					5	5
32	Fakulteti i Mjekësisë Dentare	Terapi stomatologjike					5	5
		TOTAL	125	16	2	9	95	247

Kuotat e pranimit per transferim te studimeve për programet e specializimit afatgjatë për vitin akademik 2017-2018

Tabela nr. 2

Nr.	Fakulteti	Programi i studimit	Ministria e Shëndetësisë dhe MS	Kuota per transferim nga IAL te tjera
1	Fakulteti i Mjekësisë	Endokrinologji	2	
2	Fakulteti i Mjekësisë	Kardiologji	2	
Total = 12 kuota			4	8*

* Kuota për transferim studimesh do të shpërndahen sipas programeve të studimit në përputhje me kërkesat për transferim studimesh

